



Duke u bazuar në nenin 8 dhe nenin 17 shkronja (f) dhe shkronja (j) të Ligjit për Përkujdesjen ndaj kafshëve Nr. 02/L-10 (Gazeta zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, 5/2006), nenit 13 dhe nenit 58 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008) dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Pejës, Kryetari I Komunës lëshon këtë :

URDHËRESË

PËR NDALIMIN E VRASJEVE, KEQTRAJTIMIT DHE ORGANIZIMIN E GARAVE TE KUNDERLIGJSHME TE KAFSHEVE.

1. Me këtë urdhëresë **NDALOHET vrasja**, keqtrajtimi, eksperimentimi i kafshëve pa licencë, operimi kirurgjik me qëllim të modifikimit të dukjes së kafshës me të cilën largohet apo dëmtohet cila do pjesë e trupit, importimi dhe shitja e kafshëve agresive në kundërshtim me dispozitat e Ligjit, transportimi i kafshëve pa certifikatë, tregtimi i kafshëve në kundërshtim me dispozitat ligjore, organizimi i garave në të cilat testohet fuqia apo shpejtësia e kafshës me ç ‘rast kafsha mund të pësoj dhembje, lëndime, apo ngordhje apo bënë organizimin e tyre në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe përdorimi i substancave për kafshë që marrin pjesë në gara të cilat nuk janë të përcaktuara me dispozitat ligjore.
2. Urdhëresa do të prodhoj efekte juridike në tërë territorin e Komunës së Pejës.
3. Subjektet të cilat bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese do të ndëshkohen me gjobë prej **100 deri 5.000€ sipas nenit 17 të Ligjit për Përkujdesje ndaj Kafshëve.**
4. Për zbatimin e kësaj urdhërese do të përkujdeset Drejtoria për Inspektim në Komunën e Pejës.
5. Urdhëresa hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me urdhëresë të njoftohen:

- Drejtoria për inspektim
- Zyra për marrëdhënie me publikun
- Qendra për shërbim me qytetar
- Arhiva.

I.nr. 320/01-9246/2019
Pejë, 21.Janar 2019



[Signature]
Gazmend Muhaxheri
Kryetari i Komunës